

Departamenti i Prokurimit

Prishtine datë, 24.05.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.05.2021 të parashtruar nga Grupi i Operatori Ekonomik “PMC” SH.P.K. & N.SH. “Kastrioti”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me makina pastrimi”, me Nr. të Prok: 616 21 037 121 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi i Operatori Ekonomik “PMC” SH.P.K. & N.SH. “Kastrioti”, të dt. 20.05.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me makina pastrimi”, me Nr. 616 21 037 121 Nr. Brendshëm **616-21-1071-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 17.05.2021 .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i Operatori Ekonomik “PMC” SH.P.K. & N.SH. “Kastrioti” me datë 20.05.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me makina pastrimi”, me Nr. 616 21 037 121 Nr. Brendshëm **616-21-1071-1-2-1**,

Autoriteti Kontraktues, me datë 24.05.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë dhe ka konstatuar si vijon :

-Edhe pse kërkesa juaj nuk është publikuar në Platformën elektronike E prokurimi, siqë e kërkojnë dispozitat ligjore, për korektesi do të përgjigjemi në pretendimet tuaja:


-Pretendimi juaj lidhur me nevojën e kerkimit të sqarimeve shtese lidhur me specifikat teknike është plotësisht i pa bazuar, pasi që edhe kur nuk cekën kriteret me minimum apo maksimum është e qartë për secilin se nuk mund të pranohen artikuj me specifika më të dobëta nga ato të kërkuara;

-Poashtu pretendimi se me sqarime shtese keni mund të ofroni mall me specifikat e kërkuara është në kundërshtim me rregullat për prokurimin publik, pasi që sipas FDT-se variantet nuk pranohen dhe poashtu në vend të sqarimit nuk mund të kërkohet plotësim i tenderit, respektivisht artikull dhe përshkrim i ri.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit